



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës

01-08Nr.

320/01-14481/21

Kaçanik, 28.05.2021

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale, Rregulloren Komunale 2007/30, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NË BUJQËSI NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FAKTORËT TJERË

1. Me këtë vendim formohet komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (reshjet e shiut, borës, breshërit, erërat, ngricat e hershme etj) si dhe dëmet e shkaktuara nga egërsirat, (ujku, ariu, derri egër etj), në territorin e Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje:

1. Zylfi Koxha, Koordinator I Sektorit për
2. Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi dhe Blegtori
3. Arian Teneqja, Inxh. Ndërtimtarisë

2 Komisioni ka për detyrë që sipas kërkesave të dalë në teren, të vlerësoj dëmet e shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësit natyrore (reshjet e shiut, borës, breshërit, erërat, ngricat e hershme, etj.) si dhe dëmet e shkaktuara nga faktorët tjerë, egërsirat (ujku, ariu, derri egër etj) dhe të hartoj raport me shkrim, me të cilin njoftohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

3. Me këtë Vendim njoftohen: Arkivi i Komunës, DBZHRP-së, dhe Anëtarët e Komisionit.



Kryetari i Komunës

Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01 - Nr. 104/02-11053/21
Kaçanik; 24.05.2021

Në bazë të Ligjit 03/L-040 - Për Vetëqeverisjen Lokale, Statutit të Komunës së Kaçanikut, në bazë të Procesdresës së Thesarit të Kosovës për urdherkthim të mjeteve financiare si dhe Aktvendimit C.Nr.249/20 të dt. 03.06.2020, Kryetari i Komunës, mori këtë:

V E N D I M PËR KTHIM TË MJETEVE

1. Me këtë vendim lejohet kthimi i mjeteve financiare për pagesat e kryera nga z.Bashkim Topojani pronar-perfaqësues i biznesit BK GROUP në shumë prej 1,800€ (3 pagesa nga 600.00euro)
2. Kthimi i mjeteve bëhet për arsye se z.Bashkim Topojani pronar-perfaqësues i biznesit BK GROUP në cilësinë e qeramarrësit, ka depozituar në llogari të komunes në emër të marrëveshjes për qera të Objektivit të QEAP Agimi-Kaçanik, e cila marrëveshje nga organet komunale është cilësuar jovalide dhe me këtë rast është hapur padi ndaj paleve nënshkruese të kësaj marrëveshje.
3. Kthimi i mjeteve bëhet nga llogaria bankare e komunes së Kaçanikut në logarinë bankare të z.Bashkim Topojani pronar-perfaqësues i biznesit BK GROUP në NLB BANK 1703001012644418
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit dhe Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.

Bashkëngjitur vendimit:

- Padi për anulim të kontratës 01 21/03-9930 dhe
- Aktvendimi 01 21/03-11068 i dt.03.06

Me vendim njoftohen:

1. Zyra e Kryetarit
2. Drejtoria e Financave
3. Thesari MF
4. Pala BK Group dhe
3. Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAÇANIK



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Data	19.05.21	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	400/01-13584/1
		Shtojcë	

Zyra e Kryetarit

Kaçanik, 18.05.2021

Duke u bazuar në nenin 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 73 të Statutit të komunës së Kaçanikut, pas propozimit dhe konsultimit me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, në kuadër të drejtave dhe përgjegjësi si Zyrtar Kryesor Administrativ, kryetari i komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

Për lejimin e mjeteve financiare për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut

- I. Me këtë vendim lejohen mjetet buxhetore për rregullimin dhe ndërtimin e disa rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut, të kontratë me nr. KA652/20/057/521
 1. Rregullimi dhe asfaltimin e rrugës "TMK-së" dhe Rexhep Teneqja ne fshatin Stagovë
 2. Rregullimi dhe asfaltimin e rrugës në fshatin Sllatinë
 3. Shtrimi me kubëza të betonit i rruges "Lepenci"-Kaçanik
 4. Rregullimi dhe asfaltimi në degëzimit të rrugës "Sallah Luzha" në fshatin Begracë
- II. Mjetet buxhetore nga pika 1 e këtij vendimi do të ndahen nga kategoria buxhetore "Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve lokale në zonat urbane dhe rurale" me Kod 50201, nga Programi Buxhetor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- IV. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i komunës
2. Drejtoria për Financa dhe Ekonomi dhe
3. Arkivi komunal.

Besim Ilazi
Kryetar i komunës